

VENDIM
Nr.331, datë 2.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN PËR ZBATIMIN E KODIT RRUGOR
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.153, DATË
7.4.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 99 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “d” e pikës 1 të nenit 248, pjesa III “Dokumente për qarkullimin dhe regjistrimin”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) Targat e mjeteve të trupit diplomatik: sfondi i bardhë, shkronjat dhe numrat të gjelbra. Shenja dalluese CD (Corpus Diplomaticum) (Figura III 4d/1.a dhe figura III 4d/2.a).”.

2. Në shtojcën X, neni 245, shkronjat “ë” dhe “g” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“ë) Targa e mjeteve të trupit diplomatik mban, sipas radhës, emblemën e flamurit kombëtar, dy karaktere alfabetike “CD”, dy karaktere numerike, vijë lidhëse dhe tri karaktere numerike. Për motomjetet mban dy karaktere alfabetike “CD”, emblemën e flamurit kombëtar, një karakter alfabetik dhe tri karaktere numerike (figura III 4h/1).”.

“g) Targa e mjeteve të shërbimit të trupit diplomatik mban, sipas radhës, emblemën e flamurit kombëtar, dy karaktere alfabetike “TR”, dy karaktere numerike, vijë lidhëse dhe dy karaktere numerike. Për motomjetet mban dy karaktere alfabetike “TR”, emblemën e flamurit kombëtar, një karakter alfabetik dhe tri karaktere numerike (figura III 4h/2).”.

3. Tabelat “Figura III 4d/1.a”, “Figura III 4d/2.a”, “Figura III 4h/1” dhe “Figura III 4h/2” zëvendësohen me tabelat me të njëjtin emërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Tabelat “Figura III 4d/1.b” dhe “Figura III 4d/2.b” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha




fig. III 4 d/1.a




fig. III 4d/2.a.




fig. III 4h/1




fig. III 4h/2